EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8424
E mërkurë, 4 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Rama: Serbia mbetet e mbyllur ndaj çështjes së Kosovës, nuk po shohim shenja ndryshimi FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA KRITIKON QEVERINË PËR MUNGESËN E UNIFORMAVE TË POLICËVE, RAMADANI KËRKON DORËHEQJEN E SVEÇLËS FAQE 4



Mungesa e uniformave për policët e Kosovës raportohet se e ka shtyrë ceremoninë e diplomimit të gjeneratës së re. Lidhur me këtë çështje deputetët e opozitës e kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës, duke e cilësuar qasje joserioze trajtimin e institucioneve të sigurisë. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Mërgim Lushtaku, ka thënë se mosfurnizimi me uniforma dhe kapela është skandaloz, duke kërkuar përgjegjësi nga Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Edhe deputeti i Aleancës, Burim Ramadani, e ka kritikuar ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, duke thënë se kushtet e punës për policët janë të mjerueshme

QEVERIA MIRATON PROJEKTBUXHETIN: RRITJE PAGASH, SHTESASH PËR FËMIJË DHE MBËSHTETJE PËR ISH-KRERËT E UÇK-së F. 3



RUSIA E ZHVENDOS LUFTËN PËRTEJ FRONTIT, SA E SIGURT ËSHTË KOSOVA? F. 4



AKTUALE



BETEJA PËR KONGRESIN, TEST PËR TRUMPIN F. 2

MUNGESA E DEPUTETËVE TË LV-së PAMUNDËSON RAPORTIMIN E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS NË KOMISION F. 6

EKIPI MEDIAL I HASHIM THAÇIT RIKTHEN PUBLIKIMET NË PROFILET ZYRTARE NË 'FACEBOOK' DHE 'X' F. 3

EKONOMI



ASK: RRITEN ÇMIMET E PRODHIMEVE BUJQËSORE NË KOSOVË F. 8

MINISTRIA E EKONOMISË NDAN NJË MILION EURO PËR FONDIN E KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË F. 8

SPORT



RRETH 70 MILIONË EURO BUXHETI I MINISTRISË SË SPORTIT DHE RINISË PËR VITIN 2027 F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BETEJA PËR KONGRESIN, TEST PËR TRUMPIN

UASHINGTON, 3 NËNTOR - Zgjedhjet e mesmandatit në Shtetet e Bashkuara mund ta ndryshojnë raportin e forcave në Uashington dhe të ndikojnë në dy vjetët e mbetur të presidencës së Donald Trumpit.

Amerikanët kanë nisur votimin më 3 nëntor për përbërjen e re të Kongresit.

Edhe pse Trumpi nuk është në fletëvotim, rezultati do të jetë një test i rëndësishëm për presidencën e tij dhe për mundësinë e zbatimit të agjendës politike.

Republikanët synojnë ta ruajnë shumicën në të dyja dhomat e Kongresit, ndërsa demokratët përpiqen ta marrin kontrollin e të paktën njërës prej tyre. Kjo do t'u jepte demokratëve më shumë mundësi t'i pengojnë nismat legjislative të presidentit dhe të ushtrojnë mbikëqyrje ndaj administratës së tij.

Zgjedhjet zhvillohen në një kohë kur kostoja e jetesës, gjendja e ekonomisë dhe imigracioni janë ndër shqetësimet kryesore të votuesve amerikanë.

Sipas një sondazhi të Reuters/Ipsos, të zhvilluar nga 22 deri më 26 tetor, 53 për qind e votuesve që pritet të marrin pjesë në zgjedhje, mbështesin kandidatët demokratë, kundrejt 44 për qind që mbështesin republikanët. Megjithatë, epërsia në nivel kombëtar nuk garanton fitore, pasi shumica në Kongres do të përcaktohet nga rezultatet në garat e veçanta zgjedhore.

Interesimi për zgjedhjet është reflektuar edhe në votimin e hershëm.

Sipas të dhënave të Universitetit të Floridës, të raportuara më 1 nëntor, mbi 54 milionë amerikanë kanë votuar para ditës së zgjedhjeve.

Për çfarë votojnë amerikanët?

Zgjedhjet e mesmandatit mbahen çdo katër vjet, në gjysmën e mandatit të presidentit amerikan.

Në këto zgjedhje nuk votohet për presidentin, por për anëtarët e Kongresit - institucionit që miraton ligje, vendos për shpenzimet federale dhe mbikëqyr punën e administratës.

Kongresi përbëhet nga dy dhoma: Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati.

Në Dhomën e Përfaqësuesve, ku anëtarët zgjidhen çdo dy vjet, në garë janë të 435 vendet.

Në Senat, ku anëtarët kanë mandate gjashtëvjeçare, këtë vit votohet për 35 nga 100 vendet. Prej tyre, 33 janë pjesë e zgjedhjeve të rregullta, ndërsa dy të tjera, në Florida dhe Ohajo, janë zgjedhje të posaçme për t'i plotësuar mandatet e senatorëve që u larguan para kohe.

Amerikanët votojnë gjithashtu për guvernatorë në 36 shtete dhe tri territore amerikane, si dhe për anëtarë të legjislaturave shtetërore dhe zyrtarë të tjerë lokalë.

Çfarë është në lojë për republikanët dhe demokratët?

Republikanët kontrollojnë aktualisht të dyja dhomat e Kongresit, duke i dhënë Trumpit mbështetje për ta çuar përpara agjendën e tij legjislative.

Në Senat, republikanët kanë 53 vende, demokratët 45, ndërsa dy senatorë të pavarur bashkëpunojnë me demokratët. Për ta marrë shumicën, demokratëve u duhet të fitojnë të paktën katër vende neto shtesë.

Në Dhomën e Përfaqësuesve, ku nevojiten 218 vende për shumicën kur të gjitha vendet janë të plotësuara, epërsia e republikanëve është më e ngushtë.

Ndër garat që mund të ndikojnë në përcaktimin e shumicës në Senat janë ato në Maine, Miçigan, Karolinën e Veriut, Ohajo, Teksas dhe Alaskë.

Demokratët synojnë të përfitojnë nga pakënaqësitë ndaj administratës Trump, ndërsa republikanët kërkojnë mbështetje për vazhdimin e politikave të presidentit.

Pse zgjedhjet konsiderohen test për Trumpin?

Zgjedhjet e mesmandatit shihen tradicionalisht si një test për presidentin amerikan, pasi ua japin votuesve mundësinë ta shprehin qëndrimin e tyre ndaj politikave të tij.

Historikisht partia e presidentit shpesh humbet vende në Kongres gjatë këtyre zgjedhjeve.

Këtë vit Trumpi është faktor i rëndësishëm në vendimin e votuesve.

Sipas një sondazhi të Qendrës Kërkimore Pew, 63 për qind e votuesve të regjistruar thonë se presidenti është faktor në votën e tyre për Kongresin.

Nga të gjithë votuesit e regjistruar të anketuar, 44 për qind thonë se vota e tyre është kundër Trumpit, ndërsa 19 për qind se është në mbështetje të tij.

Ekonomia, ndërkohë, mbetet në krye të shqetësimeve.

I njëjti sondazh, i zhvilluar nga 28 shtatori deri më 4 tetor, tregon se 84 për qind e votuesve të regjistruar e konsiderojnë atë shumë të rëndësishme për votën e tyre.

Kostoja e jetesës, përfshirë çmimet e ushqimeve, banimit, energjisë dhe kujdesit shëndetësor, ka qenë në qendër të debatit elektoral.



Një tjetër çështje që ndan dy partitë është imigracioni.

Republikanët mbështesin politikat e ashpra të administratës Trump për kontrollin e kufijve, ndërsa demokratët kritikojnë mënyrën e zbatimit të tyre dhe pasojat për imigrantët.

Edhe lufta me Iranin ka hyrë në debatin zgjedhor, veçanërisht për shkak të rritjes së çmimeve të karburanteve dhe pakënaqësive me mënyrën se si administrata Trump e ka menaxhuar konfliktin.

Për Trumpin, rezultati do të jetë një tregues i mbështetjes për presidencën e tij, por edhe një faktor që mund t'ia lehtësojë ose vështirësojë zbatimin e politikave gjatë pjesës së mbetur të mandatit.

Si po përpiqet Trumpi ta shpëtojë shumicën republikane në Kongres?

Në ditët e fundit para zgjedhjeve, Trumpi forcoi fushatën për t'i ndihmuar republikanët ta ruajnë kontrollin e Kongresit. Gjatë fundjavës ai mbajti tubime në Florida, Ajova dhe Kansas - tri shtete ku kishte fituar në zgjedhjet e mëparshme.

Vizitat e tij në këto shtete, që tradicionalisht kanë mbështetur republikanët, pasqyrojnë përpjekjet e partisë për t'i mobilizuar votuesit edhe në zona që më parë konsideroheshin të sigurta.

Trumpi iu drejtua gjithashtu përmes telefonit mbështetësve të kandidatëve republikanë në Miçigan, Ohajo dhe Pensilvani.

Përballë pakënaqësive për rritjen e kostos së jetesës, presidenti u përpoq ta zhvendoste vëmendjen drejt kritikave ndaj demokratëve, veçanërisht për politikat e tyre të imigracionit dhe ekonomisë. Ai pretendoi se demokratët do t'i hapnin kufijtë dhe do t'i rëndonin financiarisht familjet amerikane nëse merrnin kontrollin e Kongresit.

Trumpi mbrojti gjithashtu politikat e tij tregtare dhe të imigracionit, duke deklaruar se demokratët e kishin lënë vendin në një "epokë të errët", ndërsa administrata e tij e kishte kthyer në atë që ai e quajti "epoka e artë e Amerikës".

Çfarë ndodh nëse demokratët fitojnë kontrollin e Kongresit?

Nëse demokratët marrin shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve, ata do të kenë më shumë mundësi t'i bllokojnë nismat legjislative të Trumpit dhe të ushtrojnë mbikëqyrje ndaj administratës së tij. Ata do të mund t'i drejtojnë komisionet parlamentare, të nisin hetime, të kërkojnë dokumente dhe të thërrasin zyrtarë për të dëshmuar. Dhoma e Përfaqësuesve ka gjithashtu kompetencën të ngrejë akuza ndaj presidentit në kuadër të procedurës së njohur si 'impeachment'. Më pas, Senati vendos nëse presidenti duhet të largohet nga detyra - gjë që kërkon votat e dy të tretave të senatorëve të pranishëm.

Nëse demokratët fitojnë shumicën në Senat, ata do të kenë mundësi të bllokojnë ose të vonojnë konfirmimin e emërimeve presidenciale, përfshirë gjyqtarët federalë dhe zyrtarët e lartë të administratës.

Nëse dy dhomat e Kongresit kontrollohen nga parti të ndryshme, miratimi i ligjeve mund të bëhet më i vështirë, duke e shtyrë Shtëpinë e Bardhë të kërkojë marrëveshje me opozitën.

Edhe nëse republikanët humbin kontrollin e Kongresit, Trumpi do të mbetet president dhe do të vazhdojë t'i ushtrojë kompetencat e tij ekzekutive. Megjithatë, do të ketë më pak hapësirë për nismat që kërkojnë miratimin e ligjvënësve.

Çfarë mund të ndryshojë për Evropën dhe Kosovën?

Rezultati i zgjedhjeve mund të ketë ndikim edhe përtej Shteteve të Bashkuara, veçanërisht në marrëdhëniet me aleatët dhe në çështjet e sigurisë.

Kongresi ka rol të rëndësishëm në miratimin e fondeve për mbrojtjen dhe ndihmën e jashtme.

Një ndryshim i shumicës në njërën ose të dyja dhomat mund të ndikojë në vendimet për mbështetjen ndaj Ukrainës, angazhimin amerikan në NATO dhe marrëdhëniet me Evropën.

Megjithatë, presidenti amerikan ruan kompetenca të gjera në drejtimin e politikës së jashtme dhe në komandimin e forcave të armatosura.

Për Kosovën, rëndësia e këtyre zgjedhjeve lidhet kryesisht me angazhimin amerikan për sigurinë në rajon, përfshirë praninë e trupave amerikane në kuadër të KFOR-it, si dhe me mbështetjen diplomatike për Ballkanin Perëndimor.

Kongresi mund të ndikojë në këto çështje përmes financimit, legjislacionit dhe mbikëqyrjes së administratës. Por, ndryshimi i shumicës nuk do të nënkuptonte automatikisht ndryshim të politikës amerikane ndaj Kosovës.

Ndikimi konkret do të varet nga prioritetet e administratës Trump dhe vendimet e Kongresit të ri, mandati i të cilit nis më 3 janar 2027.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

QEVERIA MIRATON PROJEKTBUXHETIN: RRITJE PAGASH, SHTESASH PËR FËMIJË DHE MBËSHTETJE PËR ISH-KRERËT E UÇK-së



Prishtinë, 3 nëntor - Qeveria e Kosovës miratoi projektbuxhetin për vitin 2027 në vlerë prej 4.27 miliardë eurosh, i cili, sipas ekzekutivit, përfshin rritjen e shtesave për fëmijë, pagën e 13-të, rritjen e koeficientit të pagave, mbështetjen për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë dhe investime kapitale.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se buxheti i projektuar - që do t'i dërgohet Kuvendit për miratim - është 200 milionë euro më i lartë sesa buxheti i rishikuar për vitin 2026. Ai tha se të hyrat e Administratës Tatimore për vitin 2027 pritet të jenë sa 60 për qind e të hyrave që do të mbledhë Dogana. "Po rritet ekonomia e po shtohet punësimi", tha Kurti në mbledhjen e qeverisë më 2 nëntor. Ai shtoi se në tremujorin e parë të këtij viti, rritja ekonomike ishte 5.4 për qind, ndërsa në tremujorin e dytë ishte 5.1 për qind.

Sipas Kurtit, buxheti i vitit 2027 do të jetë i investimeve të mëdha kapitale. "Për herë të parë, buxheti parasheh mbi 1 miliard euro vetëm në kategorinë e investimeve kapitale. Këtu përfshihet ndërtimi i rrugëve të reja, siç janë: unaza e jashtme e Prishtinës, segmenti Duhël-Banullë që bashkon dy autostrada, autoudha e Dukagjinit dhe shumë rrugë të tjera rajonale dhe nacionale që parashihen të zgjerohen dhe rehabilitohen", tha ai.

Rritja e shtesave dhe pagave

Gjatë fjalës së tij Kurti tha se projektbuxheti parasheh rritjen e shtesave për fëmijë që, siç shpjegoi, do të ndahet në katër faza. Ai tha se në janar, shtesat do të rriten për 25 për qind, e kjo rritje do të jetë e përvitshme deri më 2030 kur, sipas tij, kompletohet dyfishimi i shtesave. Si ilustrim, ai tha se një familje që ka dy fëmijë, në janar do të marrë nga 75 euro shtesa.

Një tjetër element i projektbuxhetit është rritja e koeficientit të pagave për 120 euro dhe paga e 13-të. "Në pjesën e parë të vitit është paga e 13-të, ndërkaq në pjesën e dytë rritja e pagës për të gjithë nëpunësit. Kjo e çon buxhetin e pagave në 1 miliard e 85 milionë euro, e që kur përpjesëtohet me rreth 85 mijë nëpunës publikë, paga mesatare bruto rezulton mbi 12 mijë euro [në vit], apo mbi 1 mijë euro bruto në muaj", tha Kurti.

Punonjësit e sektorit publik e morën pagën e 13-të në mars të këtij viti.

Ata me të paktën një vit përvojë pune përfituan një pagë të plotë, ndërsa ata me më pak se një vit punë morën një shumë proporcionale me kohëzgjatjen e punësimit.

Më shumë fonde për mbrojtjen e ish-krerëve të UÇK-së

Projekbuxheti i ri parasheh edhe rritje të mbështetjes për ekipet mbrojtëse të katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që janë në burg në Hagë.

Ish-presidenti Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarët Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi dhe ish-deputeti Rexhep Selimi u dënuan në shkallë të parë për krime lufte më 16 shtator.

Qeveria është zotuar se do të ndihmojë që ky vendim, siç ka thënë, "të korrigjohet" në fazën e Apelit.

Vendi ka krijuar edhe një grup punues, që udhëhiqet nga kryediplomati Glauk Konjufca, dhe në të ka përfaqësues të partive politike.

Kurti tha të hënën se qeveria pret që ky grup të hartojë një strategji, mbi bazën e së cilës do të përcaktohen hapat e mëtejshëm për mbështetjen e ish-krerëve të UÇK-së.

Ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se do të rriten edhe fondet për barnat esenciale, duke shpjeguar se kjo rritje është një nga arsyet pse buxheti i paraparë për mallra dhe shërbime arrin në 586 milionë euro.

Murati tha se për kategorinë subvencione dhe transfere, parashihet një buxhet prej 1 miliard e 446 milionë eurosh.

Rritja prej 6.5-përqindësh, sipas tij, përfshin rritjen e shtesave për fëmijë, por edhe të pensioneve, siç është ai bazik.

Ky buxhet parasheh edhe themelimin e avionkompanisë së parë të Kosovës.

Ekspertët e aviacionit civil i kanë thënë më herët Radios Evropa e Lirë se kostot e larta dhe konkurrenca ndërkombëtare mund ta vështirësojnë qëndrueshmërinë e një kompanie të tillë shtetërore.

Miratimi i projektbuxhetit në mbledhjen e së hënës vjen mes kritikave nga opozita për shkeljen e afatit për dërgimin e tij në Kuvend.

Sipas Ligjit për Ndarjet Buxhetore, qeveria duhet ta dërgojë projektbuxhetin në Kuvend jo më vonë se 31 tetori.

Po më 31 tetor deputetja nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Hykmete Bajrami, e kritikoi Kurtin për mosdërgimin e buxhetit në Kuvend brenda këtij afati. "Ligji dhe afatet ligjore vlejnë dhe duhet të respektohen edhe nga qeveritarët", shkroi ajo në rrjetet sociale.

EKIPI MEDIAL I HASHIM THAÇIT RIKTHEN PUBLIKIMET NË PROFILET ZYRTARE NË 'FACEBOOK' DHE 'X'



PRISHTINË, 3 NËNTOR - Ekipi Medial i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka njoftuar se ka rifilluar publikimet në profilet e tij zyrtare në rrjetet sociale 'Facebook' dhe 'X'.


Përmes këtyre platformave do të publikohet material arkivor që dokumenton veprimtarinë politike dhe institucionale të Hashim Thaçit gjatë rrugëtimit të tij politik, ushtrimit të funksioneve si kryeministër, president i Republikës së Kosovës, deri në përfundim të mandatit presidencial në vitin 2020.

Postimet do të përmbajnë fotografi, video, dokumente dhe materiale të tjera historike, që pasqyrojnë aktivitetet zyrtare, takimet shtetërore dhe ndërkombëtare, fjalimet, deklaratat, vizitat, nismat institucionale dhe momentet e rëndësishme të kësaj periudhe.

Sipas njoftimit të Ekipit Medial, publikimet do të përqendrohen kryesisht në veprimtarinë e Hashim Thaçit, pa përfshirë komente, interpretime apo qëndrime lidhur me zhvillimet aktuale politike.

Profilet zyrtare në 'Facebook' dhe 'X' do të administrohen nga Ekipi Medial i ish-presidentit Hashim Thaçi, i cili do të jetë përgjegjës për përzgjedhjen, përgatitjen dhe publikimin e materialeve.

Në njoftim thuhet se këto platforma synojnë të shërbejnë si një arkiv publik për dokumentimin dhe ruajtjen e materialeve që lidhen me një periudhë të rëndësishme të historisë politike dhe institucionale të Republikës së Kosovës.



RUSIA E ZHVENDOS LUFTËN PËRTEJ FRONTIT, SA E SIGURT ËSHTË KOSOVA?

Për të shkaktuar kaos Rusisë nuk i duhen domosdoshmërisht tanke apo ushtarë. Sabotimet, sulmet kibernetike dhe operacionet e fshehta janë bërë pjesë e përballjes së saj me Perëndimin, duke vënë në provë edhe sigurinë e vendeve të NATO-s. Por, sa e cenueshme është Kosova ndaj këtyre kërcënimeve dhe sa është e përgatitur për t'u mbrojtur?

Prishtinë, 3 nëntor - Kosova nuk është në luftë, por kërcënimet që po shqetësojnë Evropën mund të mos e anashkalojnë as atë. Me mijëra trupa të NATO-s në territorin e saj, tensione të vazhdueshme me Serbinë dhe infrastrukturë kritike që tashmë ka qenë objekt sulmesh, vendi përballet me rreziqe që nuk marrin domosdoshmërisht formën e një përballjeje ushtarake.

Në pjesë të tjera të Evropës ato janë shfaqur përmes sabotimeve, sulmeve kibernetike dhe operacioneve të fshehta, të cilat janë shtuar që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës në vitin 2022.

Autoritetet evropiane kanë hetuar një varg incidentesh, disa prej të cilave janë lidhur me shërbimet ruse të inteligjencës.

Në shënjestër kanë qenë rrjetet e transportit, institucionet shtetërore dhe kompanitë që furnizojnë Ukrainën me pajisje ushtarake.

Përmes këtyre veprimeve, Moska - e cila vazhdimisht e mohon përfshirjen - dyshohet se synon ta pengojë mbështetjen për Kievin dhe të krijojë pasiguri në vendet perëndimore, pa hyrë në një konflikt të drejtpërdrejtë ushtarak me to.

Sipas një analize të Qendrës për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS), numri i sulmeve dhe planeve për sulme me pasoja fizike në Evropë, të identifikuara si të lidhura me Rusinë, është rritur nga vetëm tri në vitin 2022 në 34 në vitin 2024.

Rritja e këtyre incidenteve ka nxjerrë në pah edhe vështirësitë e parandalimit të tyre.

Një analizë e Këshillit Atlantik, e publikuar në fillim të tetorit, vlerëson se NATO-ja ka forcuar mbrojtjen ushtarake, por ende ka vështirësi në frenimin e operacioneve që mbeten nën pragun e një konflikti të hapur.

Problemi nuk qëndron vetëm te parandalimi i sulmeve, por edhe tek identifikimi i atyre që qëndrojnë pas tyre dhe përcaktimi i mënyrës së reagimit.

"Përgjigjet e NATO-s dhe të vendeve anëtare kanë qenë kryesisht reaktive dhe mbrojtëse. Ato janë përqendruar në zbulimin dhe kundërshtimin e provokimeve të caktuara, por nuk kanë arritur të dëshmojnë aftësi efektive për t'i frenuar ato", thuhet në analizë.

Përtej dëmeve materiale, operacionet e tilla mund të krijojnë frikë dhe pasiguri, duke i detyruar autoritetet të reagojnë ndaj incidenteve, përgjegjësit e të cilave shpesh mbeten të paidentifikuar.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, paralajmëroi gjatë një vizite në Talin, muajin e kaluar, se reagimet e tepruara ndaj çdo incidenti mund t'i shërbejnë Moskës.

Ai ritheksoi, njëkohësisht, vendosmërinë e Aleancës për ta mbrojtur territorin e vendeve anëtare. "Ne do të mbrojmë çdo pëllëmbë të territorit të aleatëve, pavarësisht nëse aty jetojnë njerëz apo jo, pavarësisht nëse ndodhet pranë Parisit, Talinit, Uashingtonit apo Otavës", tha Rutte.

Nga një mesazh në Telegram te një akt sabotimi

Për të kryer një operacion sabotimi nuk nevojiten domosdoshmërisht agjentë të trajnuar të inteligjencës. Ndonjëherë gjithçka mund të nisë me një mesazh në "Telegram", një detyrë të thjeshtë dhe një pagesë prej disa qindra eurosh.

Fotografimi i një objekti, mbledhja e informacioneve apo një akt vandalizmi mund t'i besohet një personi pa përvojë, i cili pranon të veprojë kundrejt pagesës. Kjo është një nga metodat që, sipas ekspertëve, përdorin shërbimet ruse të inteligjencës për të organizuar operacione në territorin evropian.

Kinga Redlowska, studiuese në Institutin Mbretëror të Shërbimeve të Bashkuara (RUSI), shpjegon se përmes kësaj taktike, organizatorët mund të angazhojnë njerëz me kosto të ulët, duke ruajtur distancën nga veprimet që kryhen në terren.

"Rusia përdor një taktikë shumë të lirë, por efektive, duke angazhuar ata që i quajmë agjentë të njëpërdorshëm. Operativët rusë rekrutojnë banorë të vendeve të Bashkimit Evropian ose të Britanisë, shpesh nga grupe të cenueshme, si studentë apo të papunë që kërkojnë të fitojnë para", thotë Redlowska për programin "Expose" të Radios Evropa e Lirë.

Detyrat mund të nisin me fotografimin e një objekti ose mbledhjen e informacioneve dhe të përshkallëzohen deri në vandalizëm apo zjarrvënie.

Edhe pagesat varen nga natyra dhe rreziku i detyrës. "Ekziston pothuajse një listë çmimesh për detyrat. Ndonjëherë shumat janë vetëm 100 ose 200 euro. Për detyra më të mëdha mund të jenë 1 000 euro, ndërsa për misione më të ndërlikuara mund të arrijnë në disa mijëra euro", thotë Redlowska.

Sipas një studimi të RUSI-t, pagesat kryhen kryesisht përmes kriptovalutave, megjithëse janë dokumentuar edhe transferime bankare dhe pagesa me para të gatshme.

Një mënyrë e tillë organizimi e bën më të vështirë zbulimin e lidhjeve mes atyre që kryejnë sulmet dhe atyre që i urdhërojnë.

Kështu, një incident që në pamje të parë duket i izoluar, mund të jetë pjesë e një operacioni shumë më të gjerë.

Për Alexander Palmerin, nga Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare, synimi i Moskës shkon përtej dëmit që mund të shkaktojë një veprim i vetëm. "Çdo pengesë apo trazirë në një vend të orientuar drejt Perëndimit shihet si diçka pozitive për Rusinë, edhe nëse ajo nuk përfiton drejtpërdrejt. Mendoj se kjo buron nga një mënyrë të të menduari, sipas së cilës, humbja e njërës palë është automatikisht fitore për tjetrën", thotë Palmer për Exposenë.

Por, për të shkaktuar dëme, nuk është gjithmonë e nevojshme as prania fizike në vendin që synohet të goditet.

Sulmet mund të kryhen edhe nga distanca përmes sistemeve digjitale.

Gjermania dhe Çekia, për shembull, kanë identifikuar sulme kibernetike që ua kanë atribuuar hakerëve të lidhur me inteligjencën ushtarake ruse.

Në Gjermani në shënjestër ka qenë Partia Socialdemokrate, ndërsa në Çeki institucionet shtetërore përmes shfrytëzimit të një dobësie në programin Microsoft Outlook.

Çfarë rrezikon Kosova?

Për Kosovën kërcënime të tilla nuk janë vetëm çështje e zhvillimeve në pjesë të tjera të Evropës.

Institucionet e saj të sigurisë kanë identifikuar tashmë një varg

RAMA: SERBIA MBETET E MBYLLUR NDAJ ÇËSHTJES SË KOSOVËS, NUK PO SHOHIM SHENJA NDRYSHIMI

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka folur për sfidat e integrimit evropian të Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, gjatë një interviste me gazetaren Maria Tadeo, në kuadër të samitit "Euronews Enlargement Summit".

Rama u ndal te marrëdhëniet e Serbisë me Kosovën dhe Bashkimin Evropian si dhe te perspektiva e anëtarësimit të Shqipërisë, duke theksuar se objektivi i qeverisë është përmbyllja e negociatave të anëtarësimit deri në fund të vitit 2027.

"Ka shumë çështje komplekse, por në fund nuk ka asgjë më të mirë se BE-ja", ka theksuar Rama. Gazetarja Maria Tadeo e pyeti Ramën nëse ndryshimet në udhëheqjen e Serbisë mund të sjellin më shumë ndërlikime në raportet e saj me Kosovën dhe Bashkimin Evropian.

Rama theksoi se, sipas tij, Serbia nuk po tregon shenja hapjeje ndaj çështjes së Kosovës. "Po nuk e ditët ju, ku ta di unë? Po pres që ta mësoj nga 'Euronews'. Ajo që di është se fituesi në Beograd nuk tregon hapje për atë që është çështja më e dashur për mua, që është çështja e Kosovës. Janë tërësisht të mbyllur, çka nënkupton se muzika nuk do të ndryshojë. Unë nuk i jap leksione askujt. Jemi pjesë e një rajoni që ende nuk është pjesë e plotë e BE-së. Ne këtu dëgjojmë leksione. Serbia është pjesë e rëndësishme e Ballkanit Perëndimor, por gjithmonë kam qenë avokat i faktit që nuk duhet ta lëmë Serbinë të shkojë në drejtimin e gabuar. Por, nëse dëshiron të hysh në BE, duhet të realizosh gjëra në disa aspekte. Serbia ka pasur qëndrim ndryshe jo vetëm për Kosovën, por edhe në lidhje me Rusinë dhe çështje të tjera. Serbia duhet të tregojë rezultate dhe duhet ta meritojë plotësisht këtë përkatësi", ka pohuar Rama.



I pyetur nëse Mali i Zi mund të anëtarësohet në BE brenda dy vjetësh për shkak të përmasave të tij, si dhe nëse pas tij Shqipëria do të jetë në "pole position" për anëtarësim, Rama tha se gjatë përvojës së tij ka parë shumë afate që nuk janë realizuar, por edhe raste kur BE-ja ka bërë më shumë sesa pritej. "Nuk jam aq i ri në këtë detyrë dhe kam parë gjëra që nuk do t'i besonit. Shoh afate që janë fashitur rrugës, sesi BE-ja nuk i ka realizuar detyrat e veta, por edhe sesi BE-ja ka bërë më shumë sesa pritej. Nuk i dihet me BE-në. Ne po punojmë fort në një plan të përbashkët për t'i mbyllur negociatat në fund të vitit 2027. Kjo do të jetë thelbësore, sepse tregon se ne e kemi bërë punën tonë", është përgjigjur Rama.

Kreu i qeverisë, Edi Rama, duke folur në "Euronews Enlargement Summit", një forum i nivelit të lartë kushtuar zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe perspektivës evropiane të vendeve aspirante për anëtarësim, u shpreh se vendi i tij ka ende probleme, por se qeveria po punon për t'i zgjidhur.

"Kemi probleme dhe po luftojmë që t'i zgjidhim, dhe procesi po na ndihmon ta bëjmë këtë gjë me mjete që nuk do t'i kishim. Nuk ka asnjëherë thelbësisht diçka ndryshe me BE-në, është një martesë ku çdo gjë është e parashikueshme. Kur bëhet fjalë për të marrë më shumë, është e lehtë ta parashikosh, kur ndodh të marrësh më pak, ndonjëherë nuk parashikohet. Ne kemi punuar shumë, kemi dhe ne ato pengesat e brendshme dhe, pavarësisht tyre, jemi siguruar që ekipi ynë të jetë në kohë në Bruksel, me këta burokratë që janë alientë në botën reale, që dinë kaq mirë të të torturojnë dhe të nxjerrin më të mirën. Kështu që zgjedh, nëse i reziston torturës, fiton; nëse jo, shkon për dreq. E kam fjalën në ndjesi", u shpreh Rama, duke folur më pas për protestat që kanë përfshirë vendin muajt e fundit, me "Flamingot" në fund të majit dhe me studentët në 13 tetor.

Rama u ndal sërish te bilanci i policëve dhe protestuesve të lënduar që, siç ka deklaruar edhe më parë, ka pasur më shumë nga radhët e policisë sesa nga protestuesit.

---

rreziqesh që mund të shfrytëzohen për destabilizim.

Në dokumentin strategjik SOCTA 2025, Policia e Kosovës përmend operacionet e fshehta, sulmet kibernetike, propagandën dhe përdorimin e grupeve joformale.

Si cenueshmëri identifikohen situata e sigurisë në veri, pakënaqësitë sociale dhe krizat energjetike.

Dokumenti paralajmëron edhe për mundësinë e shtimit të sulmeve kibernetike ndaj institucioneve, bankave dhe medieve, si dhe të përpjekjeve për të nxitur mosbesim ndaj Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara.

Disa prej këtyre rreziqeve kanë marrë formë konkrete në Kosovë qysh më herët.

Në maj të vitit 2024 faqet e internetit të Presidencës, Kryeministrisë dhe disa institucioneve të tjera mbetën përkohësisht të paarritshme pas sulmeve kibernetike.

Incidentet ndodhën pas deklaratave të ministrit të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, në mbështetje të Ukrainës.

Disa grupe proruse morën përgjegjësinë për sulmet, ndërsa Qeveria e Kosovës fajësoi hakerët rusë. Megjithatë, përcaktimi i autorëve të një sulmi kibernetik është më i ndërlikuar sesa identifikimi i adresës nga e cila ai kryhet.

Kujtim Gashi, ish-drejtor i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit në Kosovë, shpjegon se sulmuesit mund të përdorin serverë ndërmjetësues dhe pajisje të kompromentuara për ta fshehur origjinën. "Fakti që një sulm vjen nga një IP adresë apo një infrastrukturë e vendosur në një shtet të caktuar, nuk dëshmon 100 për qind se origjina e atij sulmi vjen po nga ajo adresë apo ai shtet", thotë Gashi për "Exposenë".

Rreziqet për Kosovën nuk kufizohen vetëm në hapësirën digjitale.

Në nëntor të vitit 2024 një shpërthim dëmtoi kanalin e Ibër-Lepencit, nga i cili varen furnizimi me ujë i disa qyteteve dhe nevojat e prodhimit të energjisë elektrike. Autoritetet e Kosovës e cilësuan incidentin si sulm terrorist dhe akuzuan Serbinë për përfshirje. Beogradi e mohoi përgjegjësinë.

Për rastin janë ngritur akuza ndaj tre personave. Megjithatë nuk janë paraqitur prova publike që ta lidhin atë me shërbimet ruse të inteligjencës apo me operacionet e sabotimit të hetuara në Evropë.

Rasti, sidoqoftë, nxori në pah se çfarë pasojash mund të ketë goditja e një infrastrukture nga e cila varen shërbimet jetike. Por, a kanë identifikuar institucionet e Kosovës përpjekje për rekrutim, sabotim apo mbledhje informacionesh rreth objekteve të tilla?

Kjo mbetet e paqartë.

Radio Evropa e Lirë kërkoi përgjigje nga policia dhe Prokuroria e Kosovës për këto çështje, ndërsa Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe misionit të NATO-s, KFOR, u drejtoi pyetje për kërcënimet kibernetike.

Asnjëri prej këtyre institucioneve nuk u përgjigj deri në publikimin e këtij artikulli.

Ekspertët e sigurisë, ndërkohë, paralajmërojnë se Ballkani Perëndimor ka karakteristika që mund ta bëjnë të cenueshëm ndaj operacioneve destabilizuese. Palmer vlerëson se Rusia e sheh rajonin si terren të përshtatshëm për to për shkak të historisë së tij të afërt dhe ndarjeve të brendshme politike. Ai përmend dyshimet për organizim trazirash, plane për grushte shteti dhe përfshirje të grupeve të armatosura në rajon.

Por, nuk e konsideron domosdoshmërisht praninë e NATO-s si arsyen kryesore që mund ta bëjë Kosovën objektiv. "Nuk është e qartë për mua nëse prania e bazës së NATO-s është një nga faktorët kryesorë që e bëjnë Kosovën të cenueshme. Mendoj se ky rajon perceptohet si një pjesë më e paqëndrueshme e botës dhe Rusia, sipas meje, ka qasje më të lehtë në vende të tilla, për shkak të historisë relativisht të re të institucioneve dhe ndarjeve të brendshme politike", thotë Palmer.

Një raport i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, i publikuar në dhjetor të vitit 2025, vlerëson se Rusia e shtrin ndikimin e saj në Kosovë kryesisht përmes lidhjeve me popullsinë serbe dhe shfrytëzimit të tensioneve ndëretnike. Sipas raportit, dezinformimi, ndërhyrjet politike, sulmet kibernetike dhe presioni ekonomik janë ndër metodat që përdoren për të nxitur përçarje dhe për ta penguar integrimin euroatlantik të rajonit.

Sa e përgatitur është Kosova?

Nëse një sulm do ta ndërpriste funksionimin e institucioneve apo të shërbimeve jetike në Kosovë, sa shpejt do të mund të rikthe heshin ato?

Kjo është një nga pyetjet kryesore që shtrohet për kapacitetet mbrojtëse të vendit.

Një raport i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, i publikuar në gusht të vitit 2026, identifikon dobësi në koordinimin institucional, komunikimin gjatë krizave dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike.

Në skenarin më negativ për vitin 2030, autorët përshkruajnë një Kosovë të përballur me incidente të përsëritura të sigurisë, sabotime, ndërprerje të shërbimeve nga sulmet kibernetike dhe përhapje të dezinformimit.

Ky nuk është një parashikim, por një skenar që ilustron se çfarë pasojash mund të kenë dobësitë ekzistuese nëse nuk adresohen.

Një nga pikat e ndjeshme është infrastruktura digjitale shtetërore. Qendra Shtetërore e të Dhënave, e administruar nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, strehon platformën eKosova dhe regjistrat shtetërorë.

Një ndërprerje e rëndë e funksionimit të saj mund të ndikojë në shërbimet që qytetarët dhe institucionet marrin përmes këtyre sistemeve.

Ministria e Digjitalizimit thotë për Radion Evropa e Lirë se qendra ka mekanizma të sigurisë fizike dhe kibernetike, por nuk sqaron se sa kohë do të duhej për rikthimin e shërbimeve kritike pas një ndërprerjeje, as kur është testuar për herë të fundit një plan i tillë.

Sipas Gashit, Kosova ka kapacitete për mbrojtjen e sistemeve, por mbetet problem mungesa e një infrastrukture rezervë sipas standardeve. "Kosova nuk e posedon sipas standardeve një qendër shtetërore të rimëkëmbjes së të dhënave në rast të fatkeqësive, apo një 'disaster recovery center', e cila mund të shërbejë si infrastrukturë për vazhdimësinë e shërbimeve", thotë ai.

Ministria e Digjitalizimit konfirmon se një qendër e tillë është ende në fazën e projektimit, në kuadër të një projekti të mbështetur nga Banka Botërore.

Përgatitjet për t'u përballur me kërcënimet kibernetike mbeten të papërfunduara edhe në aspektin ligjor dhe institucional.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, i vitit 2025, konstatoi se vendi ka miratuar tetë nga 14 aktet nënligjore për sigurinë kibernetike dhe kërkoi funksionalizimin e Agjencisë për Siguri Kibernetike dhe Këshillit Kombëtar për Siguri Kibernetike.

Një hap përpara u shënua në gusht, kur ekipi qeveritar GovCERT u akreditua në rrjetin ndërkombëtar Trusted Introducer, i cili mundëson shkëmbimin e informacioneve për kërcënimet dhe incidentet kibernetike mes ekipeve të specializuara në Evropë.

Ky bashkëpunim ka rëndësi të veçantë përballë kërcënimeve që nuk njohin kufij.

Në operacionet e sabotimit të hetuara në Evropë, personat që kryejnë sulmet, ata që i organizojnë dhe burimet e financimit mund të ndodhen në vende të ndryshme.

Prandaj, sipas Redlowskës, një nga mënyrat për t'i zbuluar këto rrjete është ndjekja e rrjedhës së parave. "Autoritetet duhet t'i ndjekin gjurmët e parave që në fillim. Pagesat mund të lidhin individë që, në pamje të parë, nuk kanë asnjë lidhje me njëri-tjetrin", thotë ajo.

Por, kur pagesat kryhen përmes kriptovalutave, hetimi kërkon bashkëpunim edhe përtej kufijve shtetërorë. "Kriptovalutat nuk njohin kufij. Edhe krimi i organizuar vepron përtej kufijve, ndaj edhe përgjigjja duhet të jetë ndërkufitare. Nuk mund të veprojmë të izoluar, sepse aktet e sabotimit të lidhura me Rusinë janë të shpërndara në gjithë Evropën", thotë Redlowska. Sipas saj, ky bashkëpunim duhet ta përfshijë edhe sektorin privat, veçanërisht institucionet financiare, të cilat kanë informacione që mund të ndihmojnë në identifikimin e lidhjeve mes personave të përfshirë.

Për Kosovën, tabloja mbetet e përzier.

Kërcënimet janë identifikuar, disa mekanizma mbrojtës janë forcuar, por vazhdojnë të evidentohen mangësi në përgatitje dhe të mungojnë përgjigje për kapacitetet e reagimit.

Në një mjedis ku sulmet mund të organizohen nga distanca, me kosto të ulët dhe pa paralajmërim, adresimi i këtyre çështjeve mund ta bëjë dallimin.

Gucati viziton Jakup Krasniqin e Pjetër Shalën, paralajmëron vizita te Thaçi dhe ish-krerët e tjerë të UÇK-së

Prishtinë, 3 nëntor - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVL-UÇK), Hysni Gucati, ka bërë me dije se së bashku me Elbasan Shalën, Fetah Hajrën dhe Fehmiun, ka vizituar të martën Jakup dhe Pjetër Shalën.

Përmes një postimi në "Facebook", Gucati ka thënë se të dy i kanë pritur me kokën lart dhe me bindjen se drejtësia do të triumfojë. Ai ka bërë me dije se vizitat do të vazhdojnë më 11 dhe 12 nëntor, si dhe më 30 nëntor, tek ish-presidenti Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Sali Mustafa. "Historia e tyre është e pastër si kristali", ka shkruar Gucati, duke iu referuar atyre që, sipas tij, i dhanë liri vendit.



MASH-i SHFUQIZON VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË USHAF-it PËR ZGJEDHJEN E REKTORIT AGRON BAJRAKTARI

Prishtinë, 3 nëntor - Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka marrë vendim për shfuqizimin e vendimit të Këshillit Drejtues të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), përmes të cilit Agron Bajraktari ishte zgjedhur rektor i këtij universiteti. Ky vendim është marrë me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë në universitet, pasi Këshilli Drejtues, përkundër kërkesave të vazhdueshme të Ministrisë, ka refuzuar për muaj të tërë ta shqyrtojë opinionin e Zyrës Ligjore të MASh-it dhe t'i ushtrojë përgjegjësitë e veta për adresimin e shkeljeve të konstatuara.



Opinioni ligjor ka konstatuar dy shkelje në procedurën e zgjedhjes së rektorit: mosrespektimin e detyrimit ligjor që kërkon intervistimin e kandidatëve nga të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues si dhe zgjedhjen e rektorit për një mandat të tretë, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Sot Ministria ka kërkuar nga Këshilli Drejtues që brenda tri ditëve të emërojë një ushtrues detyre të rektorit, me konsensusin e të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe t'i nisë menjëherë përgatitjet për shpalljen e konkursit të ri për rektor. Konsensusi për emërimin e ushtruesit të detyrës do të ishte një hap i rëndësishëm drejt rikthimit të bashkëpunimit dhe funksionimit të rregullt institucional.

MASh-i u bënë thirrje të gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues, stafit akademik dhe administrativ të UShAF-it, të kontribuojnë në tejkalimin e gjendjes së krijuar, përmes bashkëpunimit dhe vendosjes së interesit të universitetit mbi interesat personale.

Ministria mbetet e përkushtuar për të garantuar ligjshmërinë, respektimin e autonomisë universitare dhe funksionimin e përgjegjshëm të institucioneve publike të arsimit të lartë. MASh-i do të vazhdojë ta mbështesë UShAF-in për vendosjen e stabilitetit institucional dhe përmbushjen e misionit të tij akademik.

27 RASTE TË REJA ME FRUTH GJATË JAVËS SË FUNDIT

Prishtinë, 3 nëntor - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) i njofton qytetarët se rastet me fruth vazhdojnë të regjistrohen në vendin tonë, duke e bërë të domosdoshëm vazhdimin e përpjekjeve për rritjen e mbulueshmërisë me vaksinim dhe mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve. Sipas të dhënave të IKShPK-së, gjatë periudhës 16 prill - 1 nëntor 2026 janë konfirmuar gjithsej 269 raste me fruth, prej të cilave 27 janë regjistruar gjatë javës së fundit. "Raste të fruthit janë regjistruar tek qytetarë, pjesa dërmuese fëmijë, nga 23 komuna të Kosovës. Mbi 95 % e rasteve të konfirmuara i përkasin personave të pavaksinuar me vaksinën MMR, që mbron nga fruthi, parotiti dhe rubeola", thuhet në njoftim.

IKShPK-ja thekson se këto të dhëna theksojnë rëndësinë e vaksinimit si masa kryesore për parandalimin e sëmundjes dhe kufizimin e përhapjes së saj. "Fruthi është sëmundje shumë ngjitëse, e cila mund të shkaktojë komplikime serioze, veçanërisht te fëmijët e vegjël. Vaksinimi me kohë i mbron



fëmijët nga kjo sëmundje dhe ndihmon në mbrojtjen e komunitetit, përfshirë foshnjat dhe personat që, për arsye shëndetësore, nuk mund të vaksinohen. Krahas vaksinimit sipas Kalendarit të rregullt të vaksinimit, IKShPK-ja, në bashkëpunim me institucionet shëndetësore, po vazhdon vaksinimin plotësues (catch-up) për fëmijët që kanë mbetur pa vaksinuar ose nuk i kanë marrë të dy dozat e parapara", thuhet tutje.

IKShPK-ja thekson se gjatë këtij viti përmes këtyre aktiviteteve janë vaksinuar mbi 4 006 fëmijë të grupmoshës 2-5 vjeç. "Ky rezultat është dëshmi e rëndësisë së angazhimit të prindërve dhe profesionistëve shëndetësorë për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve. IKShPK-ja u bën thirrje të gjithë prindërve që të kontrollojnë statusin e vaksinimit të fëmijëve të tyre dhe, nëse kanë humbur ndonjë dozë, të kontaktojnë ekipet e vaksinimit për ta plotësuar atë sa më parë. Asnjë fëmijë nuk duhet të mbetet i pambrojtur për shkak të vaksinimit të vonuar ose të papërfunduar.

Vetëm përmes bashkëpunimit të prindërve, profesionistëve shëndetësorë dhe institucioneve mund të rritet mbrojtja e fëmijëve dhe të ndërpritet përhapja e fruthit. Vaksinimi është e drejtë dhe përgjegjësi e përbashkët. Mbrojtja e çdo fëmije fillon me vaksinimin në kohë", thuhet në njoftimin e IKShPK-së.

MUNGESA E DEPUTETËVE TË LV-së PAMUNDËSON RAPORTIMIN E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS NË KOMISION



Prishtinë, 3 nëntor - Raportimi i Autoritetit të Konkurrencës në Komisionin për Ekonomi është pamundësuar sërish për shkak të mungesës së deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët përbëjnë shumicën në këtë komision.

Kështu ka bërë me dije kryetari i Komisionit për Ekonomi, deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Arben Mustafa, i cili ka thënë se në mbledhjen e sotme ishte paraparë të diskutohej për pretendimet lidhur me shkeljet e shumta ligjore në këtë institucion.

Përmes një postimi, Mustafa ka kritikuar pamundësimin e vazhdueshëm të trajtimit të kësaj çështjeje, duke vlerësuar se një gjë e tillë nuk i shërben transparencës dhe llogaridhënies institucionale. Sipas tij, mosraportimi krijon mundësi që pretendimet për paligjshmëri të mbeten pa u trajtuar dhe shqetësimet për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës të vazhdojnë pa përgjigje.

Mustafa ka thënë se, pavarësisht prej pengesave, do të vazhdojë të kërkojë që kjo çështje të trajtohet në Komision, duke theksuar rëndësinë e transparencës, llogaridhënies dhe respektimit të ligjit.

Shiroka-Pula, Haxhiu dhe Vitia vaksinohen kundër gripit sezonal

Prishtinë, 3 nëntor - Kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, presidentja Justina Shiroka-Pula dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, janë vaksinuar kundër gripit sezonal në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë. Lajmin e ka dhënë Haxhiu përmes një postimi në "Facebook", ku ka theksuar rëndësinë e vaksinimit, veçanërisht në sezonin e ftohtë, kur gripi përhapet më lehtë. Ajo ka rikujtuar se pasojat e gripit mund të jenë më të rënda për të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike, ndërsa vaksinimi ndihmon në uljen e rrezikut nga infektimi dhe komplikimet e mundshme.

Haxhiu u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen, duke theksuar se mbrojtja e shëndetit është përgjegjësi e përbashkët. Ajo gjithashtu ka falënderuar personelin shëndetësor për mikpritjen dhe punën e përditshme në shërbim të qytetarëve.



OPOZITA KRITIKON QEVERINË PËR MUNGESËN E UNIFORMAVE TË POLICËVE, RAMADANI KËRKON DORËHEQJEN E SVEÇLËS

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Mungesa e uniformave në Policinë e Kosovës raportohet se e ka shtyrë ceremoninë e diplomimit të gjeneratës së re të Policisë së Kosovës, raporton "Ekonomia Online".

Lidhur me këtë çështje, deputetët e opozitës e kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës, duke e cilësuar si qasje joserioze trajtimin e institucioneve të sigurisë.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Mërgim Lushtaku, ka thënë se mosfurnizimi me uniforma dhe kapela është skandaloz, duke kërkuar përgjegjësi nga Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme. "Fatkeqësisht, këtu tregohet edhe serioziteti i pushtetit, se në çfarë gjendjeje e trajton dhe e paraqet para publikut dinjitetin e policëve të Kosovës. Me keqardhje, por është vërtet skandaloze mungesa e uniformave dhe e kapelave. Fatkeqësisht, ne duhet të merremi edhe si deputetë me çështje të tilla, të cilat, ndoshta, janë dytësore. Prandaj, sigurisht që duhet kërkuar përgjegjësi edhe nga Policia e Kosovës, por edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme, përse nuk është furnizuar Policia e Kosovës me uniforma", ka deklaruar Lushtaku.

Ndërkaq deputeti i Aleancës, Burim Ramadani, ka kritikuar ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, duke thënë se kushtet e punës për policët janë të mjerueshme. Ai ka përmendur mungesën e uniformave dhe pajisjeve elementare, jelekëve antiplumb, gomave të dimrit për automjetet e policisë, si dhe numrin e pamjaftueshëm të veturave policore. "Është fatkeqësi qeverisja e keqe e ministrit Xhelal Sveçla në Ministrinë e Brendshme, sidomos në raport me policinë. Këto situata janë të pashpjegueshme për këdo që mendon normalisht, sepse janë procese që është dashur të kryhen me kohë. Gjendja e kushteve të punës për policët e Kosovës është e mjerueshme, fatkeqësisht, dhe nuk është hera e parë që e them. Mungojnë uniformat dhe pajisjet elementare individuale që u nevojiten policëve, si shufrat e gomës dhe pajisje të tjera. Edhe kur policët detyrohen t'ia ndërrojnë uniformën njëri-tjetrit, apo kur gjeneratat e reja të policëve ende nuk kanë jelekë antiplumb, ose kur jelekëve antiplumb u ka skaduar afati, gjendja është shqetësuese. Po ashtu, gomat e dimrit për veturat e policisë kanë kaluar afatin dhe tenderi është anuluar. Veturat e policisë janë të pamjaftueshme dhe, madje, policët detyrohen t'i paguajnë vetë nga paga e tyre riparimet, përfshirë edhe shërbimet e rregullta. Pra, po flasim për një gjendje të mjerueshme të qeverisjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe policisë. Mendoj se ka ardhur



koha që ministri Xhelal Sveçla të largohet nga kjo detyrë sa më parë, sepse dëmi ndaj institucionit të Ministrisë së Brendshme dhe policisë është jashtëzakonisht i madh", ka deklaruar Ramadani.

Ramadani ka paralajmëruar se do të kërkojë sqarime edhe lidhur me lëvizjet e drejtorëve brenda Policisë së Kosovës, duke thënë se do të kundërshtojë çdo ndërhyrje me motive politike në këtë institucion. "Ne, edhe si anëtar i Komisionit për Siguri, do të kërkojmë sqarime dhe informim të plotë lidhur me lëvizjet brenda Policisë së Kosovës. Nëse ato bëhen në bazë të procedurave dhe kritereve profesionale, kjo është e kuptueshme, sepse në institucionet e sigurisë mund të ndodhin ndryshime të tilla. Por, nëse ka motive të tjera, që mund të jenë politike, atëherë do ta ngre zërin maksimalisht. Ajo që ka rëndësi është të ruhet funksionaliteti operativ i policisë. Gjatë këtyre viteve të fundit ministri Xhelal Sveçla është sjellë si komandant i policisë dhe jo si ministër, duke e shkelur kështu autonominë operative të Policisë së Kosovës", ka thënë Ramadani.

POLICIA DO T'I KTHEJË PATENTËSHOFERËT E MBAJTUR MBI TETË DITË, POR NDALESAT PËR VOZITJE MBESIN NË FUQI

Prishtinë, 3 nëntor - Policia e Kosovës ka njoftuar se do ta nisë kthimin e patentëshoferëve të marrë përkohësisht nga shoferët në rastet kur ka kaluar afati ligjor prej tetë ditësh për mbajtjen e tyre. Ky veprim vjen pas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PA. nr. 29/2026, të 20 tetorit, me të cilin është shpallur i paligjshëm dhe është shfuqizuar paragrafi 3 i nenit 17 të Udhëzimit Administrativ për Procedurat e Kundërvajtjes. Megjithatë, policia sqaron se ky vendim nuk e ndryshon mundësinë e



shqiptimit të masës mbrojtëse të ndalimit të drejtimit të automjetit dhe as nuk i shfuqizon masat e shqiptuara më parë. Sipas policisë, ndryshimi ka të bëjë vetëm me mbajtjen fizike të patentë-shoferëve, e cila, në bazë të nenit 244 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe vendimit të Gjykatës Supreme, nuk mund të zgjasë më shumë se tetë ditë.

Policia thekson se kthimi i patentë-shoferit nuk nënkupton se shoferi ka të drejtë ta drejtojë automjetin gjatë kohës sa është në fuqi masa mbrojtëse e ndalimit të drejtimit.

Ndërkaq personat që drejtojnë automjetin, pavarësisht se kanë në fuqi këtë masë, kryejnë kundërvajtje për të cilën parashihet gjobë prej 500 eurosh, ndalim i drejtimit të automjetit për gjashtë muaj, pesë pikë negative dhe konfiskim i përkohshëm i automjetit.

Policia e Kosovës ka bërë me dije se do t'i vazhdojë kontrollet në trafik dhe verifikimin e masave mbrojtëse, pikëve negative dhe kufizimeve të tjera ligjore përmes evidencave përkatëse.

Edona Podrimja emërohet zëvendësministre e Shëndetësisë

Prishtinë, 3 nëntor - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Edona Podrimjën në pozitën e zëvendësministres në Ministrinë e Shëndetësisë. Lajmi është bërë me dije në një njoftim nga qeveria, ndërsa sipas njoftimit emërimi është bërë një ditë më parë. Me këtë rast, kryeministri Kurti e ka uruar Podrimjën për detyrën e re, duke i dëshiruar suksese në përmbushjen e përgjegjësive dhe angazhimeve në pozitën e re. Podrimja tashmë do ta ushtrojë funksionin e zëvendësministres në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.



Sistemi i regjistrimit të bizneseve të Kosovës ka nevojë për përmirësime


PRISHTINË, 3 NËNTOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit për Sistemin e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (RBK), i cili përbën një komponent të rëndësishëm të infrastrukturës shtetërore për regjistrimin, administrimin dhe menaxhimin e të dhënave të bizneseve. Sistemi mundëson regjistrimin, ndryshimin dhe çregjistrimin e bizneseve dhe përmes integrimit me platformën e-Kosova mbështet avancimin e ofrimit të shërbimeve digjitale.

Rezultatet e auditimit tregojnë se sistemi mbështet në masë të konsiderueshme proceset bazë, por ka nevojë për përmirësime në automatizimin e proceseve, kontrollet e aplikacionit dhe sigurinë e informacionit.

Në kontrollet e hyrjes sistemi nuk siguron në tërësi validimin automatik të të dhënave dhe zbatimin e kërkesave ligjore e biznesore.

Mungesa e disa kontrolleve të automatizuara, përfshirë kriteret për dallueshmërinë e emrit të biznesit, krijon nevojën për verifikime manuale dhe mund të ndikojë në efikasitetin dhe kohën e ofrimit të shërbimeve.

Në kontrollet dalëse auditimi ka evidentuar kufizime në raportim, analiza dhe statistika, si dhe në funksionalitetet për korrigjimin e lëndëve. Gjithashtu, proceset e regjistrimit, ndryshimit dhe çregjistrimit nuk janë plotësisht të digjitalizuara dhe vazhdojnë të mbështeten pjesërisht në dokumentacion fizik dhe procedura manuale për shkak të



kufizimeve ligjore, mungesës së disa funksionaliteteve dhe integrimeve ndërinstitucionale.

ZKA MBAN KONFERENCËN VJETORE, SPANCA: AUDITIMI DUHET TË SJELLË NDRYSHIME NË MENAXHIMIN E PARASË PUBLIKE

Prishtinë, 3 nëntor - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka mbajtur Konferencën Vjetore me temën "Zhvillimi institucional dhe ndikimi i auditimit publik", ku janë vlerësuar të arriturat, sfidat dhe objektivat e institucionit për të ardhmen.

Në konferencë, ku morën pjesë të gjithë punonjësit e ZKA-së, diskutimet u zhvilluan në dy panele, për strategjinë dhe zhvillimin institucional si dhe për rezultatet dhe sfidat e sezonit të auditimit 2025/2026.

Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, në fjalën e hapjes theksoi se rëndësia e punës së ZKA-së nuk matet vetëm me numrin e auditimeve apo rekomandimeve por, mbi të gjitha, me ndikimin dhe ndryshimet që ajo nxit në menaxhimin e parasë publike. Ajo vlerësoi punën e përbashkët gjatë pesë vjetëve të fundit, duke theksuar se institucioni po hyn në një etapë të re të zhvillimit, me përvojë më të madhe, përgjegjësi më të larta dhe pritje më ambicioze. "Dua të shikojmë përpara dhe të reflektojmë se si mund ta shndërrojmë përvojën në zhvillim, ekspertizën në cilësi dhe cilësinë në ndikim të prekshëm për institucionet publike dhe qytetarët", deklaroi Spanca.

Ndërkaq zëvendësauditori i përgjithshëm, Bezad Halilaj, paraqiti zhvillimet dhe rezultatet kryesore të arritura nga institucioni gjatë vitit 2026. Ai tha se ZKA-ja ka ndërtuar përvojë dhe ka zhvilluar



kapacitete që kontribuojnë në përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

Gjatë paneleve u diskutua për ndikimin e auditimit dhe zbatimin e rekomandimeve, realizimin e Planit Strategjik 2023-2026 dhe orientimet strategjike për periudhën 2026-2029. Po ashtu, u paraqitën zhvillimet në metodologjitë dhe manualet e auditimit, si dhe gjetjet dhe rekomandimet nga rishikimi kolegial i SIGMA-s.

Në kuadër të konferencës u zhvilluan edhe dy sesione interaktive, ku punonjësit shprehën pikëpamjet e tyre për vizionin e institucionit dhe sfidat me të cilat përballen në punë. Me këtë rast, ZKA-ja ndau mirënjohje për punonjësit që kanë shënuar 10 dhe 20 vjet përvojë pune në institucion, për ata që janë pensionuar gjatë këtij viti, si dhe falënderoi ish-kolegët për kontributin e tyre.

Konferenca u përmbyll nga Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, e cila falënderoi stafin për punën, përkushtimin dhe profesionalizmin, duke ritheksuar angazhimin e saj për zhvillimin e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve për avancimin e mëtejmë të institucionit.

MINISTRIA E EKONOMISË NDAN NJË MILION EURO PËR FONDIN E KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Prishtinë, 3 nëntor - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe drejtoresha menaxhuese e Fondit të Kosovës për Efiçiencë të Energjisë, Njomza Hoxha, kanë nënshkruar marrëveshjen për transferimin e mjeteve në vlerë prej një milion eurosh në mbështetje të veprimtarisë së Fondit dhe avancimit të objektivave të tij në fushën e efiçiencës së energjisë. Përmes kësaj marrëveshjeje, Qeveria e Republikës së Kosovës riafirmon përkushtimin e saj për uljen e konsumit të energjisë, promovimin e përdorimit sa më efikas të saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve përmes investimeve që sjellin përfitime të prekshme dhe afatgjatë.

Mbështetja për Fondin e Kosovës për Efiçiencë të Energjisë ka qenë e vazhdueshme, ku që nga viti 2019 qeveria ka ndarë mjete me vlerë totale 10 milionë euro, me qëllim të mbështetjes së fushëveprimit dhe zgjerimit të masave për efiçiencën e energjisë në mbarë vendin.

Përkrahja për Fondin është realizuar jo vetëm përmes ndarjeve buxhetore, por edhe përmes bashkëpunimit të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë për sigurimin e financimit shtesë dhe zgjerimin e programeve që mbështesin familjet, ndërtesat shumëbanesore dhe institucionet publike.

Puna e Fondit të Kosovës për Efiçiencë të Energjisë paraqet një shembull të suksesshëm të mënyrës se si politikat publike dhe investimet strategjike mund të shndërrohen në përfitime



konkrete për qytetarët.

Përmes rinovimit të ndërtesave publike, shtëpive individuale dhe ndërtesave shumëbanesore, këto investime kontribuojnë në uljen e konsumit të energjisë, zvogëlimin e shpenzimeve për energji dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës.

Investimet në efiçiencën e energjisë u mundësojnë familjeve të gëzojnë kushte më të mira banimi, shtëpi më të ngrohta gjatë dimrit dhe më të freskëta gjatë verës, duke siguruar njëkohësisht kursime të qëndrueshme në faturat e energjisë.

Përfitimet e tyre shtrihen përtej ekonomive familjare, pasi kursimet e energjisë ndihmojnë në uljen e ngarkesës mbi sistemin elektroenergjetik, forcimin e sigurisë energjetike të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Mbështetja e vazhdueshme për Fondin përfaqëson një investim në mirëqenien e qytetarëve dhe në të ardhmen energjetike të Kosovës.

Ministria e Ekonomisë do të vazhdojë t'i mbështesë politikat dhe programet që promovojnë përdorimin efiçientë të energjisë, duke e vendosur mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm në qendër të investimeve publike.

ASK: Rriten çmimet e prodhimeve bujqësore në Kosovë

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi për tremujorin e tretë të vitit 2026, sipas të cilit, çmimet e prodhimeve bujqësore kanë shënuar rritje të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas të dhënave të ASK-së, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka shënuar rritje prej 0,8-përqindësh, ndërsa ai i prodhimeve blegtorale është rritur për 3,1 për qind.

Ndërkaq indeksi i përgjithshëm i çmimeve të prodhimeve bujqësore në tremujorin e tretë të vitit 2026 ka shënuar rritje prej 1,4-përqindësh krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2025.

ASK bën me dije se të dhënat janë mbledhur në tregje, ferma dhe vende të tjera ku mund të sigurohen çmimet e prodhimeve bujqësore vendore. Prodhimet që përfshihen në llogaritjen e indeksit ndahen në dy grupe kryesore: prodhime bimore dhe prodhime blegtorale.

Në grupin e prodhimeve bimore përfshihen drithërat, bimët foragjere, perimet, patatet dhe pemët, ndërsa në grupin e prodhimeve blegtorale përfshihen kafshët, qumështi, vezët dhe mjalti.

Çmimet janë llogaritur në euro,



ndërsa njësitë matëse të përdorura janë kilogrami, litri dhe copa.



sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Rreth 70 milionë euro buxheti i Ministrisë së Sportit dhe Rinisë për vitin 2027



PRISHTINË, 3 NËNTOR - Ministria e Sportit dhe Rinisë do të ketë në dispozicion 69.99 milionë euro për vitin 2027. Ministri Blerim Gashani ka bërë me dije se ky buxhet do të mundësojë vazhdimin e mbështetjes për sportistët, trajnerët dhe organizatat sportive, si dhe zhvillimin e projekteve strategjike në fushën e sportit dhe rinisë. "Ky buxhet do të mundësojë vazhdimin e mbështetjes për sportistët, trajnerët dhe organizatat sportive, si dhe zhvillimin e projekteve strategjike në fushën e sportit dhe rinisë. Më shumë mbështetje për sportin dhe më shumë mundësi për të rinjtë! Na priftë e mbara!", ka shkruar Gashani në rrjetet sociale.

"DARDANËT" E FUTSALLIT NISIN PËRGATITJET PËR DY NDESHJET NDAJ ITALISË

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Kombëtarja e Kosovës në futsall ka nisur përgatitjet për dy ndeshjet kundër Italisë, në kuadër të Grupit 10 të fazës Main Round të kualifikimeve për Kupën e Botës 2028.

"Dardanët" do të përballen me Italinë më 6 nëntor, në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, nga ora 20:00, ndërsa ndeshja e kthimit do të zhvillohet më 10 nëntor në Itali, po ashtu nga ora 20:00.

Përzgjedhësi i Kosovës, Agon Ramadani, ka vlerësuar se Italia është kundërshtarja më e vështirë në grup, por ka theksuar se ekipi vjen në këtë përballje pas rezultateve pozitive, përfshirë fitoren 3:2 ndaj Gjeorgjisë në udhëtim. "Italia është kundërshtari më i vështirë në këtë grup, mirëpo ne vijmë pas një ecurie pozitive, pas kualifikimit në këtë raund dhe fitores ndaj Gjeorgjisë. Normalisht, pas asaj fitoreje shtohen edhe apetitet. Ne jemi të gatshëm. Sot kemi një stërvitje relaksuese, pasi lojtarët tanë kanë zhvilluar ndeshjet e kampionatit me klubet e tyre dje, mirëpo që nga nesër do të përgatitemi me ushtrime intensive që do të na ndihmojnë jashtëzakonisht shumë për ndeshjen ndaj Italisë të premten", ka deklaruar Ramadani.



Ai ka shprehur besimin se Kosova mund të marrë rezultate pozitive në të dyja përballjet, duke vlerësuar atmosferën e mirë brenda ekipit. "Jemi në momentin e mirë dhe duhet ta shfrytëzojmë këtë. Atmosfera në ekip është jashtëzakonisht e mirë, duke i falënderuar lojtarët për këtë frymë pozitive që e kanë krijuar. Mendoj se i kemi të gjitha mundësitë për të marrë ndonjë rezultat pozitiv nga këto dy takime", ka shtuar përzgjedhësi.

Edhe kapiteni Bajram Ramadani ka shprehur optimizëm për vazhdimësinë e paraqitjeve të mira të Kosovës, duke theksuar rëndësinë e përqendrimit nga ndeshja në ndeshje. "Ecurinë e mirë që e kemi filluar këtë fushatë mezi s'kemi pritur ta vazhdojmë. Duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë dhe t'i qasemi ndeshje pas ndeshjeje, pse jo, duke synuar sukses edhe në ndeshjen ndaj Italisë", është shprehur kapiteni.

Ndërkohë Behar Selmanaj u ka bërë thirrje tifozëve "Dardanët" dhe të gjithë dashamirëve të futsallit që të jenë sa më të shumtë në numër në ndeshjen e parë ndaj Italisë për t'i dhënë mbështetje kombëtares. "Ne kemi nevojë të na përkrahin sa më shumë dhe besoj se do t'i bëjmë krenarë me paraqitjen tonë", ka thënë Selmanaj.

Kosova synon ta shfrytëzojë momentin pozitiv dhe të vazhdojë me paraqitje të mira në përballjet me Italinë, në garën për kualifikim në Kupën e Botës 2028.

KOK-u PËRMBYLL MODULIN E PESTË TË ASMC 7 ME FOKUS TEK ORGANIZIMI I NGJARJEVE TË MËDHA SPORTIVE

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Në kuadër të edicionit të pestë të Kursit të Avancuar për Menaxhimin e Organizatave Sportive (ASMC 7), për dy ditë me radhë është zhvilluar moduli me temën "Organizimi i ngjarjeve të mëdha sportive".

Ky modul ka trajtuar rëndësinë e planifikimit, menaxhimit dhe realizimit të ngjarjeve sportive të nivelit të lartë, që nga hapat e parë deri te përmbyllja e tyre dhe ndikimi në komunitet.

Ligjërues i ftuar në këtë modul ka qenë ish-sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Maqedonisë së Veriut, Sasha Popovski. Përveç tij, kanë ligjëruar edhe sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti, drejtori i programit ASMC, Ibër Alaj, si dhe drejtori i Akademisë Olimpike, Fitim Arifi.




Pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të diskutojnë për sfidat dhe mundësitë që sjell organizimi i ngjarjeve të mëdha sportive, duke shkëmbyer ide dhe përvoja nga pjesëmarrja dhe organizimi i këtyre ngjarjeve.

GJAKOVA DHE FAZLIU NGJITEN NË RANGLISTËN BOTËRORE TË XHUDOS

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Suksesi në Grand Slamin e Abu Dabit ka bërë që Akil Gjakova dhe Laura Fazliu të përparojnë në ranglistën botërore të xhudos. Vendi i pestë në kategorinë deri në 73 kilogramë i ka mundësuar Akil Gjakovës të ngjitet për 14 pozita. Tani ai renditet në vendin e 32-të në ranglistën botërore të kësaj kategorie, pasi ka fituar 360 pikë falë paraqitjes në Abu Dabi. Ndërkohë, Laura Fazliu, e cila është renditur e treta, ka fituar 500 pikë dhe është ngjitur për tri pozita në kategorinë deri në 63 kilogramë, ku tani mban vendin e 11-të. Garën e ardhshme xhudistët e Kosovës do ta kenë nga 13 deri më 15 nëntor, në kuadër të Grand Prix-it në Zagreb.



Harry Kane: Do ta sakrifikoja Topin e Artë për ta fituar Ligën e Kampionëve



MADRID, 3 NËNTOR - Sulmuesi i Bayern Munichut, Harry Kane, ka thënë se do ta zgjidhte triumfin në Ligën e Kampionëve para Topit të Artë, të cilin e ka fituar në vitin 2026. Kapiteni i Anglisë ka theksuar se trofetë kolektivë mbeten synimi i tij kryesor. "Do ta zgjidhja Ligën e Kampionëve, por e kam mundësinë t'i fitoj të dyja. Le të shohim se çfarë do të ndodhë", ka deklaruar Kane në Madrid. Kane ka konfirmuar se është shumë pranë nënshkrimit të një kontrate të re me Bayernin, duke thënë se bisedimet janë afër përfundimit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Eurokos Holding" Sh.p.k., Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e asfaltit në Grackë e Vjetër, Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.12.2026 në ora 10:00 në objektin e Kuvendit Komunal të Lipjanit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Eurokos Holding" Sh.p.k., Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për bazën e asfaltit në Grackë e Vjetër, Lipjan.

https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin
vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "HAPPY CHICKEN" SH.P.K. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin "Ferma për rritjen e shpezëve, therjen e pulave dhe prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve, ngastrat kadastrale: P-71813037-00183-0; P-71813037-00184-0 dhe P-71813084-00190-0, zona kadastrale: Korishë dhe Shpenadi, Komuna Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.12.2026 në ora 11:00 në objektin e ri te Komunës se Prizrenit, ne hapësirat e Administratës, do të organizohet debat publik nga kompania HAPPY CHICKEN" SH.P.K. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Ferma për rritjen e shpezëve, therjen e pulave dhe prodhimin e produkteve të mishit të shpezëve, ngastrat kadastrale: P-71813037-00183-0; P-71813037-00184-0 dhe P-71813084-00190-0, zona kadastrale: Korishë dhe Shpenadi, Komuna Prizren.

https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin
vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

KONSTANTINI I MADH. PERANDORI QË NDRYSHOI FATIN E KRISHTËRIMIT

Një perandor romak, një betejë vendimtare dhe një vizion misterioz që do të ndryshonte rrjedhën e historisë. Konstantini i Madh nuk ishte thjesht sundimtari që i dha fund përndjekjes së të krishterëve. Ai ishte njeriu që hapi rrugën për shndërrimin e një besimi dikur të persekutuar në një nga forcat më të fuqishme të qytetërimit. Por pas figurës së perandorit të krishterë fshihej edhe një politikan i pamëshirshëm, një strateg brilant dhe një njeri plot kontradikta

Konstantini i Madh: Njeriu që ndryshoi historinë e dy botëve

Më 28 tetor të vitit 312, dy ushtri romake u përballën pranë Urës Milviane, në veri të Romës. Në njërën anë qëndronte Maksenci, sundimtari që kontrollonte qytetin e përjetshëm. Në anën tjetër ishte Konstantini, një gjeneral ambicioz që kërkonte të bëhej zot i Perandorisë Romake.

Askush nuk mund ta dinte se kjo përplasje do të kishte pasoja që do të shkonin shumë përtej fatit të një froni.

Sipas traditës së krishterë, përpara betejës Konstantini kishte përjetuar një vizion të jashtëzakonshëm. Në qiell kishte parë një shenjë hyjnore, të lidhur me Krishtin, dhe kishte marrë mesazhin se nën atë shenjë do të fitonte. Se çfarë ndodhi realisht mbetet objekt debatesh historike. Por një gjë është e sigurt: Konstantini fitoi.

Maksenci u mbyt në lumin Tiber gjatë tërheqjes së ushtrisë së tij dhe fitimtari hyri në Romë si sundimtar i Perëndimit.

Ajo që dukej si një fitore e zakonshme në luftërat e pafundme për pushtet do të shndërrohej në një nga kthesat më të mëdha të historisë fetare dhe politike të njerëzimit.

Sepse Konstantini do të bënte diçka që perandorët e mëparshëm romakë nuk e kishin bërë. Do ta vendoste fuqinë e fronit perandorak në mbështetje të krishterimit.

Një djalë i lindur për pushtet

Konstantini lindi rreth vitit 272, në Naissus, qytetin që sot njihet si Nish. Babai i tij, Konstanci Klori, ishte një komandant ushtarak me rrënjë nga Iliria që më vonë u bë një nga sundimtarët e Perandorisë Romake. Nëna e tij, Helena, do të fitonte një vend të veçantë në traditën e krishterë.

Konstantini u rrit në një perandori të trazuar nga luftërat civile, krizat ekonomike dhe pasiguria politike.

Roma nuk ishte më ajo fuqia e qëndrueshme e shekujve të mëparshëm. Perandorët ngjiteshin në fron dhe rrëzoheshin me shpejtësi. Ushtritë shpesh vendosnin se kush do të sundonte.

Kufijtë kërcënoheshin vazhdimisht dhe pushteti ishte kthyer në një betejë për mbijetesë.

Për të shpëtuar perandorinë nga kaosi, Diokleciani kishte krijuar tetrarkinë, një sistem ku pushteti ndahej mes katër sundimtarëve. Por sistemi që duhej të garantonte stabilitetin përfundoi duke prodhuar rivalitete të reja.

Kur babai i Konstantinit vdiq në vitin 306, ushtarët e shpallën atë perandor në Eboracum, qytetin e sotëm York në Angli. Ishte fillimi i një rruge të gjatë drejt pushtetit absolut. Konstantini kishte trashëguar ambicien dhe aftësitë ushtarake të babait, por zotëronte edhe diçka tjetër: një kuptim të jashtëzakonshëm të marrëdhënies mes pushtetit, simboleve dhe besimit.

Vizioni që ndryshoi gjithçka

Historia e vizionit të Konstantinit është një nga episodet më të famshme dhe më të diskutuara të Antikitetit të Vonë. Dy autorë të krishterë, Laktanci dhe Euzebi i Cezaresë, na kanë lënë rrëfime që ndryshojnë në hollësi.

Sipas Laktancit, Konstantini u udhëzua në ëndërr që të vendoste një shenjë të krishterë mbi mburojat e ushtarëve. Euzebi, në një rrëfim të shkruar më vonë, përshkruan një shenjë të ndritshme në qiell, të shoqëruar me një mesazh fitoreje.

Me kalimin e shekujve, këto tregime u ndërthurën në legjendën e famshme të kryqit dhe fjalëve: Nën këtë shenjë do të fitosh. Por a e pa vërtet Konstantini këtë vizion? A ishte një përvojë e sinqertë fetare, një interpretim i një dukurie natyrore apo një simbol i përdorur për të legjitimuar pushtetin?

Historianët vazhdojnë ta debatojnë. Ajo që nuk vihet në dyshim është se pas vitit 312 marrëdhënia e Konstantinit me krishterimin mori një rëndësi gjithnjë e më të madhe.


Dhe kjo marrëdhënie do ta ndryshonte përgjithmonë Perandorinë Romake.

Nga të përndjekur në të mbrojtur

Përpara Konstantinit, historia e të krishterëve në Perandorinë Romake ishte shënuar nga periudha tolerimi, por edhe nga përndjekje të ashpra. Në vitin 303, gjatë sundimit të Dioklecianit, kishte filluar një nga fushatat më të mëdha kundër tyre.

Kisha u shkatërruan, libra të shenjtë u konfiskuan dhe shumë besimtarë u burgosën ose u ekzekutuan. Por përndjekjet nuk arritën ta zhduknin krishterimin. Përkundrazi, besimi vazhdoi të përhapej.

Në vitin 313, Konstantini dhe bashkësundimtari i tij, Licini, arritën në Milano një marrëveshje që garantonte lirinë e praktikimit të fesë, përfshirë krishterimin. Ajo njihet tradicionalisht si Edikti i Milanos. Ishte një kthesë historike. Të krishterët mund të ushtronin hapur besimin e tyre. Pronat e konfiskuara të bashkësive të tyre duhej të ktheheshin dhe Kisha fitoi



mundësi të reja organizimi.

Megjithatë, duhet bërë një dallim i rëndësishëm. Konstantini nuk e shpalli krishterimin fenë zyrtare të perandorisë. Kjo do të ndodhte më vonë, në vitin 380, gjatë sundimit të Teodosit I.

Por Konstantini krijoi kushtet politike dhe institucionale që e bënë të mundur atë zhvillim. Një besim që dikur kishte jetuar nën kërcënimin e autoriteteve perandorake po fitonte mbështetjen e vetë perandorit.

Besimtar i sinqertë apo politikan gjenial?

Kjo është ndoshta pyetja më interesante për Konstantinin. A u kthye ai drejt krishterimit sepse besonte vërtet, apo sepse kuptoi potencialin e tij politik? Përgjigjja nuk është e thjeshtë.

Konstantini jetoi në një epokë kur feja dhe politika ishin të lidhura ngushtë. Një sundimtar mund ta shihte mbështetjen hyjnore si burim të ligjshëm të autoritetit të tij. Dhe krishterimi ofronte një strukturë gjithnjë e më të organizuar, me bashkësi të përhapura në territore të ndryshme të perandorisë.

Por do të ishte tepër e thjeshtë ta paraqisnim vendimin e tij vetëm si një manovër politike. Konstantini ndërtoi kisha, favorizoi institucionet e krishtera dhe ndërhyri personalisht në mosmarrëveshjet fetare. Nga ana tjetër, ai vazhdoi të përdorte edhe simbole tradicionale romake, ndërsa pagëzimin e mori vetëm pak përpara vdekjes. Kjo mund të duket kontradiktore për njeriun modern, por në botën e shekullit IV, kalimi nga traditat pagane te krishterimi ishte një proces shumë më kompleks sesa një ndryshim i menjëhershëm identiteti. Dhe Konstantini ishte një figurë e atij tranzicioni.

Një njeri me njërën këmbë në botën e vjetër dhe tjetrën në botën që po lindte.

Perandori që kërkonte një Zot dhe një perandori

Në vitin 324, pas fitores përfundimtare kundër Licinit, Konstantini u bë sundimtari i vetëm i Perandorisë Romake. Por bashkimi politik nuk mjaftonte. Krishterimi, që tashmë gëzonte mbështetjen perandorake, ishte i përfshirë në debate të thella teologjike.

Një nga konfliktet më të rëndësishme lidhej me mësimet e Arit, një prift nga Aleksandria, dhe me marrëdhënien mes Krishtit dhe Zotit Atë. Për Konstantinin, këto përçarje nuk ishin vetëm çështje fetare, ato rrezikonin unitetin e perandorisë.

Prandaj, në vitin 325, ai thirri Këshillin e Nikesë, një nga ngjarjet themelore të historisë së krishterimit. Peshkopë nga vise të ndryshme të perandorisë u mblodhën për të diskutuar çështjet më të rëndësishme të doktrinës. Këshilli miratoi një formulim të besimit që pohonte natyrën hyjnore të Krishtit dhe dënoi mësimin e Arit.

Konstantini nuk ishte teologu që hartoi doktrinën, por ishte autoriteti politik që bëri të mundur mbledhjen. Këtu u shfaq një marrëdhënie e re historike. Perandori nuk ishte më vetëm mbrojtësi i kufijve dhe ligjeve romake. Ai po bëhej edhe garant i unitetit të Kishës.

Një model që do të ndikonte marrëdhëniet mes fesë dhe shtetit për shumë shekuj.

Kostandinopoja: Qyteti që do të mbijetonte një mijë vjet

Konstantini nuk ndryshoi vetëm historinë fetare, ai ndryshoi edhe hartën politike të botës. Në vitin 330, përuroi një kryeqytet të ri mbi qytetin e lashtë të Bizantit, në brigjet e Bosforit. Qyteti do të njihej si Kostandinopojë.

Vendndodhja ishte strategjike: lidhte Evropën me Azinë dhe kontrollonte rrugë të rëndësishme tregtare e ushtarake. Me kalimin e kohës, Kostandinopoja do të bëhej zemra e Perandorisë Romake të Lindjes dhe një nga qendrat më të mëdha të krishterimit.

Ndërsa Roma perëndimore do të binte në shekullin V, kryeqyteti i Konstantinit do të vazhdonte të qëndronte deri në vitin 1453. Për më shumë se një mijë vjet, qyteti mbajti gjallë trashëgiminë politike romake, kulturën greke dhe traditën e krishterë lindore.

Ishte një nga arritjet më jetëgjata të Konstantinit.

Konstantini i Madh dhe ana e errët e perandorit të krishterë

Por historia e Konstantinit nuk është vetëm histori besimi dhe ndërtimi. Është edhe histori dhune. Në vitin 326, perandori urdhëroi ekzekutimin e djalit të tij të madh, Krispit. Po atë vit vdiq edhe bashkëshortja e tij, Fausta, në rrethana që burimet historike nuk i shpjegojnë qartë.

Legjendat e mëvonshme krijuan versione dramatike për tradhti, intriga familjare dhe hakmarrje. Por historianët nuk kanë prova të mjaftueshme për të rindërtuar me siguri atë që ndodhi.

Konstantini nuk ishte pra, thjesht figura e idealizuar e traditës fetare. Ai ishte edhe një perandor romak, i formuar nga një kulturë ku lufta për pushtet mund të përfundonte me eliminimin e kundërshtarëve, madje edhe brenda familjes. Madhështia historike dhe ashpërsia personale bashkëjetonin tek i njëjti njeri.

Pagëzimi i fundit dhe trashëgimia e përjetshme

Në pranverën e vitit 337, Konstantini u sëmur rëndë. Duke ndier afrimin e vdekjes, ai mori pagëzimin nga peshkopi Euzeb i Nikomedisë. Më 22 maj të atij viti, perandori vdiq. Ishte rreth 65 vjeç. Ai la pas një perandori të transformuar, një kryeqytet të ri dhe një marrëdhënie të re mes pushtetit politik dhe krishterimit.

Në traditën e krishterë lindore, Konstantini dhe nëna e tij Helena nderohen si shenjtorë. Por rëndësia e tij historike shkon përtej vlerësimeve fetare. Konstantini nuk e krijoi krishterimin dhe as nuk e bëri menjëherë fenë e vetme të botës romake. Ai bëri diçka që, në planin historik, ishte po aq vendimtare. I hapi dyert e pushtetit perandorak një feje që deri atëherë kishte jetuar shpesh në margjinat e tij.

Dhe nga ai moment, historia e Evropës, e Mesdheut dhe e krishterimit nuk do të ishte më e njëjta. Nëse Konstantini kishte përjetuar vërtet një vizion hyjnor përpara Urës Milviane, ndoshta nuk do ta dimë kurrë. Nëse vendimet e tij ishin fryt i besimit, i ambicies politike apo i një përzierjeje të të dyjave, kjo do të vazhdojë të diskutohet. Por një fakt mbetet i padiskutueshëm. Në fillim të shekullit IV, krishterimi ishte një fe që sapo kishte dalë nga një periudhë përndjekjesh të rënda. Në fund të jetës së Konstantinit, ai ishte një besim i mbështetur nga vetë froni i perandorisë më të fuqishme të Mesdheut. / bota.al

AFD NË GJERMANI RISHIKON QËNDRIMIN KUNDËR EUROS DHE BE-së



Partia e ekstremit të djathtë në Gjermani, Alternativa për Gjermaninë (AfD), po rishikon qëndrimin e saj historik kundër euros dhe Bashkimit Europian, në një përpjekje për t'u paraqitur si një forcë politike më e pranueshme për aleatët e mundshëm dhe për të rritur shanset për të hyrë në pushtetin federal.

Sipas një analize të publikuar nga Reuters, pas fitores historike në zgjedhjet rajonale në Saksoni-Anhalt në shtator, AfD-ja është më pranë se kurrë mundësisë për të marrë pjesë në qeverisjen kombëtare përpara fundit të dekadës. Partia kryeson aktualisht në sondazhet kombëtare, ndërsa rritja e ndikimit të forcave të djathta në Evropë po e shtyn të rishikojë strategjinë e saj për të ardhmen e kontinentit.

E themeluar në vitin 2013, në kulmin e krizës së borxheve në Eurozonë, AfD-ja nisi si një lëvizje kundër monedhës së përbashkët dhe ndihmës financiare për vendet me borxhe të larta. Më vonë, kritikat e saj u zgjeruan ndaj vetë Bashkimit Evropian, ndërsa kundërshtimi i emigracionit u shndërrua në një nga shtyllat kryesore të mbështetjes elektorale.

Megjithatë, një pjesë e drejtuesve dhe anëtarëve të partisë po argumentojnë se, në kushtet kur partitë e djathta radikale po fitojnë ndikim në disa vende evropiane, është më efektive të synohet ndryshimi i BE-së nga brenda sesa largimi prej saj.

"Që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, perspektivat për reformimin e BE-së në përputhje me vizionin tonë nuk kanë qenë kurrë më të mira", deklaroi deputeti i AfD-së, Sebastian Münzenmaier.

Strategjia e re: Reformim i BE-së, jo domosdoshmërish largim

Një sinjal i këtij ndryshimi ishte dokumenti strategjik i prezantuar muajin e kaluar nga bashkëkryetarja e AfD-së, Alice Weidel, në Parlamentin Europian në Strasburg. Dokumenti, i titulluar "Një marrëveshje e re për Evropën", u paraqit së bashku me aleatët e partisë në grupimin "Evropa e Kombeve Sovrane".

Propozimi e zhvendos theksin nga largimi i Gjermanisë prej euros dhe BE-së drejt rinegocimit të traktateve, me synimin për krijimin e një bashkimi më fleksibël dhe me më shumë kompetenca për shtetet anëtare.

Mes ideve të parashikuara është një mekanizëm për përjashtime nga politikat e përbashkëta, për shembull në fushën e shpenzimeve të mbrojtjes apo emigracionit, si dhe zbatimi më i rreptë i rregullave buxhetore. Kjo qasje lë të hapur mundësinë e ruajtjes së euros. Në rast se përpjekjet për reformim dështojnë, dokumenti sugjeron që drejtimi i ardhshëm evropian i Gjermanisë të vendoset përmes një referendumi.

Weidel deklaroi se AfD-ja dhe aleatët e saj mbështesin një "bashkim evropian, një Evropë të atdheve", por nuk dha një përgjigje të qartë nëse vazhdon të kërkojë largimin e Gjermanisë nga Eurozona apo nga BE-ja.

AfD kërkon të shmangë pengesat për një bashkëpunim të ardhshëm me CDU-në

Rishikimi i qëndrimeve ndaj Evropës lidhet edhe me ambicien e AfD-së për të gjetur një rrugë drejt pushtetit federal. Disa prej anëtarëve më të rinj të partisë mendojnë se qëndrimet e ashpra kundër euros dhe BE-së mund ta vështirësojnë bashkëpunimin e mundshëm me Unionin Demokristian (CDU), partinë konservatore të kancelarit Friedrich Merz, e cila aktualisht përjashton çdo aleancë me AfD-në.

Jean-Pascal Hohm, 29 vjeç, drejtues i organizatës rinore të partisë "Generation Deutschland", argumenton se zhvillimet politike në Evropë, konkurrenca në rritje nga Kina dhe pasiguria mbi besueshmërinë e Shteteve të Bashkuara e bëjnë më të nevojshëm bashkëpunimin evropian.

"Nëse do ta anulonim monedhën e përbashkët dhe secili do të ndiqte rrugën e vet, kjo do të ishte plotësisht utopike dhe do të na shkaktonte dëme të mëdha", u shpreh Hohm.

Ai shtoi se brezat e rinj evropianë, pavarësisht kombësisë, e shohin gjithnjë e më shumë veten si pjesë të Evropës dhe janë më pak të prirur të vazhdojnë konfliktet e trashëguara nga brezat e mëparshëm.

Megjithatë, kjo qasje nuk gjen ende mbështetje të plotë brenda partisë. Një rezolutë e propozuar nga Hohm në kongresin e gushtit, e cila theksonte rëndësinë e idesë evropiane përtej dimensionit ekonomik dhe monetar, u tërhoq pasi nuk siguroi mbështetjen e nevojshme.

"Çështja e euros rezultoi më e diskutueshme nga sa kishim parashikuar", pranoi ai.

Modeli i partive të tjera të djathta në Europë

AfD-ja duket se po ndjek një rrugë të ngjashme me atë të disa partive të tjera të djathta radikale në Europë, të cilat kanë zbutur qëndrimet euroskeptike për të zgjeruar mbështetjen dhe për të hyrë në qeverisje.

Në Francë, Tubimi Kombëtar i Marine Le Pen hoqi gradualisht nga programi kërkesën për braktisjen e euros, ndërsa në Itali, partia Vëllezërit e Italisë e kryeministres Giorgia Meloni ka moderuar retorikën kundër BE-së që prej ardhjes në pushtet.

Edhe Partia e Lirisë në Austri ka hequr dorë nga një pjesë e qëndrimeve të saj anti-europiane gjatë rrugës drejt pjesëmarrjes në koalicionet qeverisëse.

"Austria shërben si një model për AfD-në", tha Wolfgang Schroeder, profesor i shkencave politike në Universitetin e Kasselit, duke shtuar se heqja dorë nga këto qëndrime mund të jetë vetëm çështje kohe.

Sipas Schroeder, ekonomia gjermane, e mbështetur fort te eksportet dhe e integruar në tregjet ndërkombëtare, do të pësonte pasoja të rënda nëse vendi do të largohej nga BE-ja ose Eurozona.

Pavarësisht debateve të brendshme, AfD-ja po përpiqet të përshtatë programin e saj me realitetin e ri politik evropian. Por çështja e euros mbetet një nga temat më të ndjeshme brenda partisë, ndërsa rruga drejt pushtetit federal mund ta detyrojë atë të bëjë kompromise me disa prej parimeve mbi të cilat u themelua.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESE DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES